

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 17:12

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Z.Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, PS, LSI, PDIU**
- **Kandidatë të Pavarur:**      **Z.B.Abazi, K.Merxhani**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

**Z. Y. Merkaj:** Në zbatim të nenit 123, pika 1 të “Kodit Zgjedhor”, KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-së Qarku Berat, KZAZ-të kanë plotësuar e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë. Kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela si dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi dhe tabelat përmbledhëse origjinale të rezultateve për çdo kandidatë për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të mësipërme. Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës Zgjedhore për subjektet zgjedhore, Qarku Berat, kryesisht u verifikuan Tabelat Përmbledhëse të KZAZ nr. 63, KZAZ nr 64, KZAZ nr.65, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 67, KZAZ nr. 68 me Tabelat origjinale të Rezultatit për Qendrat e Votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Anëtarët e Grupit të Numërimit ku rezultoi se: Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për subjektet zgjedhore të KZAZ-ve, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre gjithashtu Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor të KZAZ-ve përkatëse përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Në bazë të rezultateve përmbledhëse të zonave të sipërcituara, rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor janë hartuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore Qarku Berat. Nga krahasimi i të dhënave të tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat e rezultatit të ZAZ-së përkatëse me rezultatin elektronik në sistem nuk u vërejtën mospërputhje të shifrave. Nga sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore si dhe miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputet për zonën zgjedhore qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin si dhe Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit. Përfaqësues të partive politike në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Po përfaqësuesi i LSI-së.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Përshëndetje, nqs mundem zoti Komisioner nuk kisha ndonjë kundërshin në idhje me këtë pikë të rendit të ditës. Doja vetem të bëja me dije që kemi konstatuar që në aktin tuaj të mëparshëm në mbledhjen e datës 1.05.2021 të orës 11:30 që vendimmarrja juaj për sa i përket miratimit të Tabelës Përmbledhëse për Qarkun e Kuksit në pikën 4 të saj, besoj se e keni konstatuar dhe ju, ka pasur një gabim në mënyrën e përlllogaritjes të afatit të ankimit që bëhet pranë KAS. Nuk është 3 ditë siç ishte në të, është 5 ditë.

**Z. I. Celibashi:** Po, është 5 ditë afati i ankimit. Mirë, atëherë miratohet Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për subjektet zgjedhore Qarku Berat për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 1 që bashkëlidhet këtij vendimi. Miratohen dhe Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputet për zonën zgjedhore Qarku Berat për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjeve bashkëlidhur për të gjitha subjektet zgjedhore.

**Vendimi nr.339**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 17:16

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PS, PD, LSI, PDIU**
- **Kandidatë të Pavarur**      **B.Abazi, K.Merxhani.**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të, Qarku Durrës, përkatësisht KZAZ-të numër 20, 21, 22, 23, 24 dhe 25, kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse si dhe kanë depozituar në KQZ këto tabela, gjithashtu kanë depozituar edhe tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimit të KZAZ-ve të mësipërme. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore, për subjektet zgjedhore, u kontrolluan nga administrata e KQZ-së, tabelat përmbledhëse të ZAZ-ve të mësipërme dhe me tabelat e rezultateve të çdo qendre

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

votimi të plotësuar nga anëtarët e grupit të numërimit. Tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore, përfshijnë rezultatet e të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre, kemi vërejtur mospërputhje të shifrave të QV-ve si më poshtë: KZAZ numër 22, QV 1470/4, fletë votimi të papërdorura, grupi i numërimit ka caktuar 617. Tabela përmbledhëse e rezultatit pasqyron 627, sistemi 627. KZAZ-ja numër 21, QV 1463, fletë votimi të papërdorura, grupi i numërimit ka deklaruar 598, tabela përmbledhëse e rezultatit pasqyron 590, sistemi 590. Mospërputhja e shifrave të konstatuara, kryesisht nga KQZ-ja, u korrigjuan në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet zgjedhore duke u bazuar në origjinalin e tabelave të QV, në zbatim të pikës 3 të nenit 123 të Kodit Zgjedhor. Përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit për kandidatët, kryesisht u kontrolluan tabelat përmbledhëse të KZAZ-ve përkatëse dhe rezultoi se tabelat përmbledhëse për kandidatë për deputet për çdo subjekt zgjedhor të KZAZ-ve të mësipërme, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për KZAZ-të e Qarkut Durrës. Bashkëlidhur keni projektvendimin dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Në lidhje me tabelën përmbledhëse të Qarkut Durrës?

**Z. E. Salianji:** Një pyetje kisha, se u konstatua që fletët e papërdorura kishin mospërputhje 2, 3 vota, po fletët e përdorura kanë përputhje, fletët e votimit?

**Z. Y. Merkaç:** Gjatë kontrollit vetëm fletët e papërdorura kanë patur mos rakordim.

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

**Z. E. Salianji:** Se tabela që miratojmë ne është një tabelë që ka të bëjë me numërimin e fletëve të votimit, nuk ka lidhje fare me fletët e papërdorura, se ato janë në qendrën e votimit.

**Z. Y. Merkaj:** Këtu janë pasaktësitë që janë të konstatuara. Pjesa tjetër ka qenë në rregull.

**Z. E. Salianji:** Pra fletët e votimit të cilat janë në kutitë e votimit, ka patur mos rakordim?

**Z. Y. Merkaj:** Jo.

**Z. E. Salianji:** Dakord!

**Z. I. Celibashi:** Vetëm për fletët e papërdorura,

**Z. E. Salianji:** Po nuk ka logjikë të jenë ke ky akt fletët e papërdorura, fare, se di pse e keni vënë,

**Z. I. Celibashi:** Thjesht është evidentuar si pasaktësi,

**Z. E. Salianji:** Pra e vetmja gjë që mund të duhet është për statistikë jo për tu vënë në tabelë rezultatesh kjo, nuk ka asnjë logjikë, pse, sepse i gjithë procesi që fillon nga numërimi, kutia e fletëve të votimit, numërimi, plotësimi i tabelës, miratimi i KQZ-së, ka të bëjë vetëm me fletët e votimit të përdoruar, kjo është mund ta citoni

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

por mbajeni ju si KQZ për statistikë, shikoni fletët e votimit, jo në tabelë, nuk ka pse janë tabelat, fare nuk ndikojnë në rezultat.

- Z. I. Celibashi:** Kemi gjë tjetër? Nuk kemi, diskutime të tjera? Nuk kemi. Atëherë,
1. Miratohet edhe tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Durrës.
  2. Miratohet edhe tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputet, për zonën zgjedhore Qarku Durrës, sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

**Vendimi nr.340**

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 17:21

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Dibër, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PS, PD, LSI, PDIU**
- **Kandidatë të Pavarur**      **B.Abazi, K.Merxhani.**

**Z. I. Celibashi:** Atëherë kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të e Qarkut Dibër, përkatësisht KZAZ-ja numër 16, 17, 18 dhe 19, kanë plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezulttit për çdo subjekt zgjedhor dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse, gjithashtu kanë depozituar në KQZ këto tabela si dhe tabelat origjinale të rezulttit për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimit të KZAZ-ve të mësipërme. Tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore, të KZAZ-ve, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre, gjithashtu tabelat përmbledhëse të rezultateve të

**Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI**





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

kandidatëve për deputetë për çdo subjekt zgjedhor, të KZAZ-ve të mësipërme përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi, me tabelat e rezultatit të KZAZ-ve dhe rezultatit elektronik në sistem, nuk u vërejtën mospërputhje të shifrave. Për sa më sipër, në mbështetje të neneve të sipër cituara, i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet për zonën zgjedhore Qarku Dibër, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat e rezultateve. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Diskutime, në lidhje me Qarkun Dibër, për tabelat e rezultateve?

Nuk kemi. Atëherë,

1. Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Dibër.
2. Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputet, për zonën zgjedhore Qarku Dibër, sipas lidhjeve bashkëlidhur.

**Vendimi nr.341**

*Zbardhi materialin audio  
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 17:23

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**

• **Parti Politike:**      **PD, PS, LSI, PDIU, B.Abazi, K.Merxhani**

**Z. I.Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Në lidhje me afatin e ankimit, nuk po e ripërsëris por është 5 ditë, qëndron në të gjitha rastet, në të gjitha vendimet që lidhen me miratimin e tabelës së rezultateve për secilin qark.

**Z. Y.Merkaj:** Pas përfundimit të proceseve të numërimit të votave për KZAZ-të e qarkut Shkodër, përkatësisht KZAZ-ja nr.20, 21, 22, 23, 24 dhe 25 ka plotësuar dhe miratuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse, gjithashtu ka depozituar këto tabela në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputetë, për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të mësipërme. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore, kryesisht janë kontrolluar tabelat përmbledhëse të ZAZ-ve 1, 2, 3, 4, 5,

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

6, 7, 8 me tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi të këtyre ZAZ-ve. Nga numërimi, rezultoi se tabelat përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore të ZAZ-ve të mësipërme përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të qendrave të tyre të votimit. U vërejtën mospërputhje të shifrave të QV-ve si më poshtë:

Në KZAZ nr.3, qendra e votimit 0304, fletë votimi të pavlefshme, grupi numërimit 8, tabela përmbledhëse, rezultati 7, sistemi 7.

ZAZ-ja nr.3, qendra e votimit 0304, fletë të vlefshme, grupi numërimit 355, tabela përmbledhëse e rezultatit 356, sistemi 356.

Për ZAZ nr.3, QV 0304, subjekti PD - Aleanca për Ndryshim, grupi i numërimit ka caktuar 166 fletë votimi, tabela përmbledhëse e rezultatit pasqyron 165 dhe sistemi pasqyron 165.

ZAZ-ja nr.3, qendra e votimit 0244/1, vota të pavlefshme, grupi i numërimit 17, tabela përmbledhëse e rezultatit 18, sistemi 18.

ZAZ-ja nr.3, qendra e votimit 0244/1 vota të vlefshme, grupi i numërimit 256, tabela përmbledhëse e rezultatit 255, sistemi 255.

Mospërputhje shifrash të konstatuara, kryesisht nga KQZ-ja, janë korrigjuar në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet bazuar në origjinalin e tabelave të qendrave të votimit. Përpara plotësimit tabela përmbledhëse për kandidatët e zonës zgjedhore, kryesisht u kontrolluan tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-ve të mësipërme dhe konstatohet se janë në përputhje dhe nuk janë përfshirë të gjitha rezultatet e tabelave të qendrave të votimit të tyre. Për sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës për sa më sipër. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

**Z. I.Celibashi:** Faleminderit! Për tabelën e rezultatit të Qarkut Shkodër kemi diskutime? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

**Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Po, i nderuar! Këtu tek tabela përmbledhëse e Qarkut Shkodër, kemi një gabim, pasi me sa shikoj, janë mbledhur vetëm 3 ZAZ, nga të gjitha ZAZ-të, tek tabela përmbledhëse, tek totali. Është mbledhur pikërisht ZAZ 6,7 dhe 8. Domethënë tek totali, tek numri total nuk janë mbledhur që nga ZAZ 1 e në vijim por...

**Z. Y.Merkaj:** Është korrigjuar! Është shpërndarë e vjetra, por është korrigjuar.

**Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Dakord, në rregull! Nuk arrinim ta dallonim se po ecnim me këtë tabelën këtu.

**Z. I.Celibashi:** Kemi një kopje? Jepi një kopje përfaqësuesit!

**Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Në rregull, s'ka problem. Në qoftë se është rregulluar, ajo është rregulluar, se këtu na vjen me vendim. Faleminderit!

**Z. I.Celibashi:** Kjo që është shfaqur në monitor është e sakta!

**Z. L.Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Më shumë për t'ju ndihmuar dhe juve zoti Komisioner!

**Z. I.Celibashi:** Faleminderit! Mirë, atëherë miratohet dhe tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për subjektin zgjedhor, për zonën zgjedhore, Qarku

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

Shkodër. Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët për deputetë, për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër sipas lidhjeve respektive.

**Vendimi nr.342**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 17:27

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, LSI, PS, PDIU**
- **Kandidatë të pavarur**      **Bojken Abazi, Kreshnik Merxhani**

**Zoti I. Celibashi:** Atëherë, vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Zoti Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të ZAZ-ve të qarkut Tiranë, përkatësisht KZAZ-ja 26; 27; 28; 29; 30; 31; 32; 33; KZAZ-ja 34; 35; 36; 37; 38; 39; 40; 41; 42 dhe KZAZ-ja nr. 43 kanë plotësuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për subjektin zgjedhor dhe për kandidatin për deputet të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në komisionin qendror të zgjedhjeve këto tabela së bashku me tabelat origjinale të rezultatit të subjekteve zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve të kandidateve për deputete për çdo subjekt zgjedhor për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të mësipërme. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet është kryer kryesisht

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

kontrolli i këtyre tabelave nga administrata e KQZ-së; dhe është konstatuar se përfshihet rezultati i të gjitha tabelave me rezultatet e qendrave të votimit të tyre.

Janë vërejtur mospërputhje dhe shkelje si më poshtë:

Në KZQAZ-në 35, qendra e votimit 1839, vota të pavlefshme të konstatuara nga grupi i numërimit 19; tabela përmbledhëse e rezultatit 42; sistemi 42;

KZAZ-ja nr. 26, qendra e votimit 1551, subjekti ADR, grupi i nr. 0 vota; tabela përmbledhëse e rezultateve 1 votë; sistemi 1 votë.

KZAZ-ja nr. 46, qendra e votimit 1551, subjekti LN, grupi i nr. 1 votë; tabela përmbledhëse e rezultateve 0 vota; sistemi 0 vota.

KZAZ-ja nr. 34, qendra e votimit 1785/2, subjekti PSD, grupi i nr. 13 vota; tabela përmbledhëse e rezultateve 14 vota; sistemi 14 vota.

KZAZ-ja nr. 34, qendra e votimit 1785/2, subjekti PBK, grupi i nr. 1 votë; tabela përmbledhëse e rezultateve 0 vota; sistemi 0 vota.

KZAZ-ja nr. 29, qendra e votimit 2090, subjekti ADR, grupi i nr. 3 vota; tabela përmbledhëse e rezultateve 6 vota; sistemi 6 vota.

KZAZ-ja nr. 29, qendra e votimit 2090, subjekti LN, grupi i nr. 0 vota; tabela përmbledhëse e rezultateve 3 vota; sistemi 3 vota.

Mospërputhja e shifrave kryesisht të konstatuara nga KQZ-ja, u korrigjua në tabelën përmbledhëse të rezultateve për zonat zgjedhore të subjekteve duke u bazuar në tabelat origjinale të qendrave të votimit.

Përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore për kandidatet për deputetë të subjekteve zgjedhore u kontrolluan nga administrata e KQZ-së dhe konstatohet se përfshihet rezultati i të gjitha tabelave të qendrave të votimit të tyre. Me përjashtim të ZAZ-së nr. 40, për subjektin PD-AN, nuk ishte pasqyruar në sistemin elektronik rezultati paraprak, ai i qendrës së votimit nr. 1938.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

Nga kontrolli i bërë për qendrat e votimit të kësaj KZAZ-je dhe për të gjithë kandidatët e subjekteve zgjedhore të evidentuara nga sistemi elektronik u vërejtën mospërputhje si më poshtë:

KZAZ-ja nr. 40, qendra e votimit 1079, për kandidaten nr. 32, subjekti PSD, nga votimi dhe numërimi elektronik 0 vota; votimi paraprak në sistem 2 vota; për kandidaten 35 të subjektit PSD, nga votimi dhe numërimi elektronik 2 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1987/2, për kandidaten nr. 36, subjekti PSD, nga votimi dhe numërimi elektronik 4 vota; votimi paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1980/1, për kandidaten nr. 27, subjekti ABEOK, nga votimi dhe numërimi elektronik 2 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota;


Qendra e votimit 1982/1, për kandidaten nr. 27, subjekti ABEOK, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota; për kandidaten nr. 4 të kësaj qendre votimi, subjekti ABEOK, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1981, për kandidaten nr. 36, subjekti LSI, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1986, për kandidaten nr. 36, subjekti LSI, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1989, për kandidaten nr. 24, subjekti LSI, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota; për kandidaten nr. 25, subjekti LSI, nga votimi dhe numërimi elektronik 2 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota; për kandidaten nr. 35, subjekti LSI, për këtë qendër votimi, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

Qendra e votimit 1984/1, për kandidaten nr. 17, subjekti PD-AN, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1986/1, për kandidaten nr. 21, subjekti PD-AN, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1996/1, për kandidaten nr. 21, subjekti PD-AN, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1989, rezultatet e kësaj qendre votimi nuk janë pasqyruar në sistem. për LN, qendra e votimit nr. 1981, kandidati nr. 31, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota; kandidati nr. 11 i këtij subjekti nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;


Qendra e votimit 1986/1, për kandidaten nr. 18, i Lëvizjes për Ndryshim, i kësaj qendre votimi, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota; kandidati 26, nga votimi dhe numërimi elektronik 1 votë; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Qendra e votimit 1980/1, për kandidatin nr. 14, i PS-së, nga votimi dhe numërimi elektronik 0 votë; rezultati paraprak në sistem 2 vota;

Për kandidatin nr. 15, i PS-së, nga votimi dhe numërimi elektronik 2 vota; rezultati paraprak në sistem 0 vota;

Mospërputhja e shifrave të konstatuara kryesisht nga ana e KQZ-së, u korrigjua në tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet duke u bazuar në tabelat origjinale të qendrave të votimit. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit për këtë KZAZ me të gjitha ndryshimet e korrigjuara mbështetur në tabelat origjinale për çdo qendër votimi. Bashkëlidhur keni projektin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit të kësaj KZAZ-je. Faleminderit!


*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

**Zoti I. Celibashi:** Faleminderit, tani përpara se t'u jap fjalën përfaqësuesve të partive politike, nëse do të kenë ndonjë diskutim në lidhje me tabelën përmbledhëse të rezultatit për qarkun Tiranë, gjej rastin që të bej edhe një sqarim, në lidhje me çfarë është thënë në disa media, si dhe në rrjetet sociale në lidhje me rezultatin e votimit elektronik të bërë në zonën 40 dhe pasqyrimin e këtij rezultati në faqen e internetit të KQZ-së. Se është pak e çuditshme që përtojnë të pyesin në KQZ, për të thënë si ka mundësi kjo mospërputhje?! ... dhe në këtë rast do të kishin marrë edhe përgjigjen përkatëse. Rezultati i shpallur në orën 8:00, të datës 26 dhe në përgjithësi të gjitha subjektet zgjedhore e kanë marrë rezultatin e votimit në këtë zonë zgjedhore menjëherë, qoftë për subjektet qoftë për kandidatët e këtyre subjekteve; ndaj dhe nuk ka pasur asnjë shqetësim nga përfaqësuesit e partive politike në lidhje me rezultatin e pasqyruar në zonën zgjedhore me nr. 40. Raportet që u prodhuan nga sistemi elektronik ishin të sakta dhe reflektonin mënyrën e votimit në këtë zonë zgjedhore. në faqen e internetit të KQZ-së, hedhja e këtyre të dhënave është bërë në mënyrë manuale pasi sistemi i votimit elektronik nuk është i përputhur. Nuk u përputh për shkak të mungesës së kohës dhe sistemit tjetër elektronik të përpunimit dhe të marrjes së informacionit nga qendrat e numërimit, për rastet e numërimit të fletëve të votimit në mënyrë manuale. Ndaj edhe në rastin e zonës zgjedhore nr. 40, të dhënat e tabelave të rezultatit qofte për subjektet zgjedhore, qofte për kandidatët, janë hedhur në mënyrë manuale dhe gjatë këtij procesi janë bërë edhe këto gabime. Por, nuk ka patur asnjë lloj shqetësimi qoftë për partitë politike, qoftë edhe për kandidatët në këtë zonë, sepse e kanë marrë rezultatin dhe tabelën e rezultatit të votimeve në këtë zonë zgjedhore që në orën 8:00 të mëngjesit të asaj dite. Ndaj nuk ka pasur shqetësim nga subjektet zgjedhore por ka pasur shqetësim nga një pjesë e medias apo të tjerë të interesuar, por edhe ata do të ishin qetësuar sikur të kishin marrë

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

mundimin të kishin bërë një pyetje në KQZ se perse ishte kjo mospërputhje. Nuk vjedh KQZ-ja vota; Ka ndonjë diskutim tjetër në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?! Nuk kemi! Atëherë miratohet edhe tabela përmbledhëse e rezultateve të votimit për qarkun e Tiranës. Po, më fal!

**Zoti B. Abazi:** Më falni se nuk e dija se po kalohej në pikën e radhës të rendit të ditës, ... mendova se ishte nënpika që po kalohej; prandaj nëse mundem për të bërë disa komente lidhur me qarkun Tiranë.

**Zoti I. Celibashi:** Po patjetër:

**Zoti B. Abazi:** Unë si kandidat i pavarur dhe si përfaqësues i lëvizjes vetëvendosje do të depozitoj ankime për pjesën tonë përkatëse në KQZ dhe në KAS.

Por nëse do të përmbledhja disa fragmente që kemi parë lidhur me parregullsitë dhe shkeljet në qarkun Tiranë do të thosha që nisur nga vëzhgimet, dhe veçanërisht vëzhguesit e akredituar të VV-së janë penguar nga kryetarët e KZAZ-ve dhe nga vetë anëtarët efektivë të policisë, në mënyrë të paligjshme! Unë si kandidat jam penguar për të hyrë në qendrën e numërimit, është një ndarje e pabarabartë e hapësirës brenda në qendrën e numërimit që ka ndodhur në mënyrë arbitrare si dhe përzgjedhja arbitrare nga ana e KZAZ-ve në raport me atë se ku i vendosin vëzhguesit dhe se cilët vëzhgues kanë të drejtë të hyjnë dhe cilët jo; duke mos lejuar kështu praninë e vëzhguesve në shumicën e rasteve gjatë procesit të numërimit të votave dhe dorëzimit të kutive brenda qendrës së numërimit. Lidhur me këtë shqetësim unë kam edhe një pyetje dhe pyetja është se nëse nga ana e KQZ-së është vërejtur apo konstatuar kjo gjë zyrtarisht nga ju pasi ne kemi bërë edhe komunikime zyrtare publikisht lidhur me këto parregullsi. Dhe veçanërisht për disa raste flagrante si ai i shkollës “Bajram Curri”, në Allias, në datën 26 Prill, apo ai i katundit të ri në zonën e Kasharit. Për më tepër siç edhe ju e dini, janë 18200 fletë të pavlefshme në


*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

qarkun e Tiranës, dhe kemi dëgjuar që do të këtë një ekspertizë lidhur me këto çështje; ne jemi shumë të interesuar të kuptojmë çfarë do të thotë kjo?! ... A do të këtë ekspertizë? A do të jemi të ftuar ne si përfaqësues ankimues së bashku me subjektet e tjera për të marrë pjesë në këtë lloj ekspertize? Pasi ne jemi të bindur që ka ekzistuar një lloj plani, në mënyrë të orkestruar, për të deformuar vullnetin e qytetareve; duke vendosur 2 X-a, nganjëherë 3 X-a në të njëjtën fletë votimi, dhe nëse dikush pretendon se qytetarët mund të jenë ngatërruar, .. ta zëmë të kenë zgjedhur numrin 12 dhe 13 duke menduar se po përzgjidhte ta zëmë, kandidatin e PS që ishte me numrin 12, kjo është e pashpjegueshme që e njëjta gjë ka ndodhur edhe në Lezhë edhe në Gjirokastër ku nuk ekzistojnë 13 kandidatë; në këtë rast Gjirokastra ka 4 Lezha ka 7. Ne kemi bërë publike edhe disa pamje të fotografive që kemi marrë nga filmimet, ... mirëpo një pyetje që gjithashtu do të doja ti parashtroja KQZ-së, është nëse janë në dijeni të faktit që sapo përmenda. Së pari falënderoj për pamjet filmike që ne kemi marrë lidhur me tabelat pas orës 3 sot, kështu që ka qenë shumë e vështirë për ne sot që ne ti analizojmë të gjitha ato me kujdes; lidhur me pamjet fimike, që ne kemi marrë dhe janë me terra-byte dhe jo me giga-byte siç edhe ju e dini, mungojnë pamjet fimike të KZAZ-së 31, data 26 prill nga ora 17 e vijim, kamera 360\* nuk ekziston, kjo të paktën në materialin që na është dhënë ne. Së dyti, KZAZ 33, data 26 prill nga ora 02:00 e vijim, kamera 360\* nuk ekziston asnjë material në të. KZAZ 39, për të gjitha të dhënat mungon kamera 360\*. Nuk e di nëse ky është një problem teknik, që ne nuk na është dhënë materiali; nuk e di nëse KQZ-ja e ka konstatuar mungesën totale të këtyre pamjeve filmike, apo thjesht nuk na është dhënë ne si material; do ta vlerësonim nëse mund të sqarohet kjo pikë, dhe nëse ma lejon një vërejtje që edhe kur ka pamje në këto kamera 360\*, pothuajse nuk kuptohet asgjë. Shfrytëzoj rastin që në zgjedhjet e radhës të këtë më shumë kamera


*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

të këtij lloj pasi ato poste numërimi që janë larg kamerave 360\* paraqesin një pamje të deformuar të personave që janë në tavolinë, duke mos kuptuar asgjë lidhur me dengun e letrave që vendosen në mënyrë të ndarë sipas subjektit gjatë numërimit të tyre. Nga vëzhguesit tanë është raportuar se fletët e votimit janë shpallur të pavlefshme pa asnjë arsye; dy raste konkretë që i kemi evidentuar, pasi, për më shumë, siç edhe ju e dini kjo gjë kërkon kohë, të paktën 5 ditë për të bërë analizën e plotë të pamjeve filmike, megjithatë, p.sh.. në KZAZ-në nr. 30, në Bërzhitë, qendra e votimit 1607, ne aty kemi evidentuar 2 vota, për kandidatin e pavarur, për mua konkretisht, Bojken Abazi, të pa numëruara; aty kemi dalë me 0 vota; tek njësia 7; KZAZ-ja 37, në qendrën e votimit 1902/2, kemi evidentuar 5 vota shtesë, të pastra pa një X të dytë, të cilat nuk janë pasqyruar në tabelë; dhe jemi duke u marrë dhe me pamje të tjera filmike dhe nuk janë duke u përmendur me dhjetëra dhe qindra fletë votimi që kanë shenjën X tek nr. 13 dhe një shenjë tjetër X me stilolaps, që duket hapur se është një tjetër bojë dhe me një tjetër formë të shkruar të X-it. Kjo na jep dyshimin e bazuar që këtu ka pasur një deformim të votës dhe që fakti që është ky deformim mund të ketë ndodhur edhe në bashkëpunim midis komisionerëve numëruës. Duhet të kemi parasysh që gjatë procesit të numërimit edhe kamerat që tregojnë skanerët nuk e kanë pamjen e plotë, sepse janë lëvizur me shpejtësi! Kryetarët e KZAZ-ve kanë kërcënuar vëzhguesit tanë me largim nga salla e numërimit kur ne kemi ngritur shqetësime; kanë kërcënuar me largim nga salla e numërimit kur ne kemi kërkuar të fotografojmë dhe të filmojmë dhe ne nuk jemi në dijeni të ndonjë rregulli të KQZ-së, që e ndalon këtë gjë! Nëse ekziston ndonjë rregull i tillë do ju lutesha të na e bënit me dije. Kemi raste si në Katundin e Ri në datën 26 prill, kur ka ndodhur numërimi i votave të subjektit politik vetëm me pjesëmarrjen e një grupi të numëruësve, pa prezencën e subjekteve të tjera, madje

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

një nga vëzhguesit tanë na ka treguar që në Katund të Ri, një nga numëruesit vendoste X-a para fytyrës së vëzhguesit tonë, për faktin se ky refuzonte të largohej. Kështu që do të ishte e rëndësishme që të shikoheshin ato pamje. Për sa i përket procesverbaleve edhe nga edhe nga aspekti teknik, tek Shkolla e Kuqe ne kemi raportuar edhe në KQZ, faktin që si subjekt nr. 13 ne jemi zhdukur nga raportimi atë ditë; nuk jemi në dijeni nëse ato vota janë pasqyruar apo jo, në tabelat që ju keni nxjerrë sot dhe nuk e di nëse, kjo është edhe në formë pyetje, pra a ka konstatuar KQZ këtë problem edhe në qendra të tjera të numërimit, ...?! nëse e ka trajtuar këtë problem duke qenë se është raportuar edhe publikisht,?! Besoj se përfaqësuesit e tjerë do të flasin për pamjet filmike si në rastin e Gjirokastrës, që tregon një shkelje penale nga ana e gjithë komisionarëve që vendosin X-a në fletë dhe nuk e di nëse ka vepruar KQZ-ja dhe cila ka qenë përgjigja e bërë publike, apo jo?, ... dhe nëse jo pse jo! Ju faleminderit!

**Zoti I. Celibashi:** Faleminderit zoti Abazi! Paraprakisht dua t'ju sqaroj që nga pikëpamja procedurale, sot ne miratojmë tabelat e rezultateve bazuar në tabelat e rezultateve të çdo qendre votimi. Kjo nga njëra anë do të thotë një pasqyrim rigoroz të asaj çfarë KZAZ-ja për çdo qendër votimi ka depozituar dhe ka prezantuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; nga ana tjetër kjo nuk ju heq juve të drejtën që ju të prezantoni të gjitha ato shqetësime që ju keni, por të cilat në një mënyrë më efektive ju duhet ti prezantoni nëpërmjet një ankimi brenda pesë ditëve duke filluar nga dita e sotme. Gjithsesi, përtej kësaj, dua t'ju ri-konfirmoj që tej interesit të çdo subjekti zgjedhor, edhe KQZ ka interes të shikojë se si ka qenë sjellja e komisionarëve, anëtarëve të grupeve të numërimit gjatë procesit të nxjerrjes së rezultatit. Ne i disponojmë të gjitha filmimet, e kemi bërë publik këtë fakt, do bëjmë edhe në këqyrjet tona dhe së bashku me të gjitha ata që janë të interesuar do ti

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

adresojmë kryesisht në organin e prokurorisë të gjitha ato gjetje të cilat konsistojnë në mospërputhje të asaj që duket në pamje filmikë me ato çfarë kanë pasqyruar në tabelën e rezultateve. Nëse ndonjëri nga anëtarët e grupeve të numërimit apo anëtarëve të KZAZ-së, e ka menduar si një gjë që kjo do të kalojë, kjo nuk do të ndodhë! Juve jeni dëshmitarë për ato që jeni dëshmitarë, edhe ne për atë pjesën tonë. Kështu që të sigurojmë se nuk do të jemi indiferentë në këtë çështje. Në lidhje me kërkesat tuaja për të marrë filmime të atyre KZAZ-ve që nuk i keni marrë, besoj që lehtësisht duke filluar edhe nga sot edhe nga nesër, mund ti merrni filmimet e atyre KZAZ-ve, pamjet e të cilave juve ju mungojnë! Po kështu edhe pamjet e kamerave 360\*! Apo jo drejtor?!

**Zoti N. Mezini:** Mund ti marrin! Nuk ka asnjë lloj problemi.

**Zoti I. Celibashi:** ... E kam fjalën edhe nga pikëpamja teknike nuk ka asnjë problem?!

**Zoti N. Mezini:** Jo, nuk ka!

**Zoti I. Celibashi:** Faleminderit, atëherë kalojmë në miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore, zonën zgjedhore, qarku Tiranë, si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, sipas lidhjeve përkatëse, faleminderit!

**Vendimi nr. 343**

**Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

4.05.2021  
Ora 17:50

**RENDI I DITËS**

Projektakti “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, LSI, PS, PDIU**
- **Kandidatë të pavarur**      **Bojken Abazi, Kreshnik Merxhani**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të e Qarkut Elbasan, përkatësisht KZAZ nr.44, KZAZ nr.45, KZAZ nr. 46, KZAZ nr. 47, KZAZ nr. 48, KZAZ nr. 49, KZAZ nr. 50, KZAZ nr.51, KZAZ nr. 52 dhe KZAZ nr. 53, kanë plotësuar e miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela, së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputetë për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve përkatëse. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore Qarku Elbasan, kryesisht u kontrolluan nga administrata e KQZ-

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

së tabelat përmbledhëse të ZAZ-ve të mësipërme. Gjithashtu u kontrolluan edhe tabelat përmbledhëse për kandidatët për deputetë të kësaj zone zgjedhore nga ku u konstatua se përfshihet rezultati i të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre. Në bazë të përmbledhjes së rezultatit të zonave të sipërcituara, rezultatet për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për çdo subjekt zgjedhor, janë hartuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore Qarku Elbasan. Për sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe tabelat përmbledhëse për kandidatë të zonës zgjedhore Qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit e qendrave të votimit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, diskutime nuk kemi?! Atëherë,

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Elbasan.

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Elbasan, sipas lidhjeve bashkëlidhur këtij projektvendimi.

**Vendimi nr.344**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

**4.05.2021  
Ora 17:52**

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Vlorë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, LSI, PS, PDIU**
- **Kandidatë të pavarur**      **Bojken Abazi, Kreshnik Merxhani**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të e Qarkut Vlorë, përkatësisht KZAZ nr.83, KZAZ nr. 84, KZAZ nr. 85, KZAZ nr. 86, KZAZ nr.87, KZAZ nr. 88, KZAZ nr. 89, KZAZ nr. 90, KZAZ nr. 91, KZAZ nr. 92, kanë plotësuar e miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela, së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi si dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve përkatëse. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore, Qarku Vlorë, kryesisht u kontrolluan nga administrata e KQZ-

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021**

së tabelat përmbledhëse të të gjithë ZAZ-ve të mësipërme dhe rezulton se: Tabela e rezultateve për subjektet zgjedhore të dhjetë ZAZ-ve përfshin rezultatin e të gjitha qendrave të votimit të këtyre ZAZ-ve. Gjithashtu tabela përmbledhëse e rezultatit të ZAZ-së 91 nuk përfshin tabelën e rezultatit të QV 4633 të Bashkisë Finiq, pasi është shpallur si kuti e parregullt. Janë vënë re mospërputhje të shifrave të qendrave të votimit si më poshtë:

KZAZ nr.86, QV 4474, fletë votimi të gjetura në kuti GN 369, TPR 368, Sistemi 368;

KZAZ nr.86, QV 4474, Partia Socialiste, GN 249, TPR 248, Sistemi 248;

KZAZ nr.86, QV 4474/1, fletë votimi të papërdorura GN 392, TPR 329, Sistemi 329;

KZAZ nr.88, QV 4560, fletë votimi të papërdorura GN 662, TPR 622, Sistemi 622;

KZAZ nr.91, QV 4693 fletë votimi të papërdorura GN 464, TPR 0, Sistemi 0.

Mospërputhja e shifrave u konstatua kryesisht nga KQZ-ja, është korrigjuar në tabelat përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet zgjedhore bazuar në tabelat origjinale të qendrave të votimit, bazuar në nenin 123, pika 3. e Kodit Zgjedhor. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputetë të zonës zgjedhore të Qarkut Vlorë rezulton se përfshijnë të gjitha tabelat e rezultateve të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore me shifrat e korrigjuara mbështetur në tabelat origjinale të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupi i numërimit si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për kandidatë të zonës zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit të këtyre ZAZ-ve, faleminderit!

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, diskutime nga përfaqësues të partive politike? Nuk kemi?! Atëherë,

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Vlorë.

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Vlorë, sipas lidhjeve respective bashkëlidhur këtij projektvendimi.

**Vendimi nr.345**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

4.05.2021  
Ora 17:56

**RENDI I DITËS**

Projektakti “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Ilirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, LSI, PS, PDIU**
- **Kandidatë të pavarur**      **Bojken Abazi, Kreshnik Merxhani**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të e Qarkut Korçë, përkatësisht KZAZ nr.69, KZAZ nr.70, KZAZ nr. 71, KZAZ nr. 72, KZAZ nr. 73, KZAZ nr. 74 dhe KZAZ nr. 75, kanë plotësuar e miratuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela përmbledhëse, së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputetë për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve. Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore Qarku Korçë, kryesisht u kontrolluan nga administrata e KQZ-së tabelat

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021**

përmbledhëse të ZAZ-ve të mësipërme. U konstatua se përfshihet rezultati i të gjitha tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre. U vunë re mospërputhje të shifrave si më poshtë:

KZAZ nr. 74, QV 3664/1, subjekti Partia Socialiste, GN 4 vota, TPR 5 vota, Sistemi 5 vota;

KZAZ nr. 74, QV 3664/1, subjekti Aleanca Demokracia e Re, GN 1 votë, TPR 0 vota, Sistemi 0 vota.

Mospërputhja e shifrave u konstatua kryesisht nga KQZ-ja, është korigjuar në tabelat përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet zgjedhore bazuar në tabelat origjinale të qendrave të votimit. Gjithashtu përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputetë të zonës zgjedhore të Qarkut Korçë rezultoi se përfshijnë të gjitha tabelat e rezultateve të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve. Në mbështetje të neneve të mësipërme i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore me shifrat e korigjuara mbështetur në tabelat origjinale të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupi i numërimit si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për kandidatë të zonës zgjedhore Qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, diskutime nuk kemi?! Atëherë,

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Korçë.

Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Korçë, sipas lidhjeve respektive bashkëlidhur këtij vendimi.

**Vendimi nr.346**

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

**4.05.2021  
Ora 17:58**

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore,  
Qarku Gjirokastër, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për  
zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:**      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**      **PD, LSI, PS, PDIU**
- **Kandidatë të pavarur**      **Bojken Abazi, Kreshnik Merxhani**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër.

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ e Qarkut Gjirokastër, përkatësisht KZAZ 76, 77, 78, 79, 80, 81 dhe 82 kanë për të miratuar dhe plotësuar tabelat përmbledhëse të rezultatit për subjektin zgjedhor dhe për kandidatët për deputet të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në KQZ këto tabela përmbledhëse së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultatit për kandidat dhe deputet për çdo subjekt zgjedhor për çdo qendër votimi të KZAZ të mësipërme. Por, para plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore për subjektet Qarku Gjirokastër, kryesisht u verifikuan tabelat përmbledhëse të ZAZ të mësipërme dhe konstatohet se përfshirë rezultatin e të gjitha tabelave rezultateve të qendrave të tyre

**Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

të votimit. Gjithashtu nga krahasimi i tabelave është konstatuar se për qendrën e votimit numër 4166 për subjektin PLDSH, grupi i numërimit ka konstatuar 0 vota, tabela përmbledhëse e rezultatit ka 1 votë, sistemi ka 1 votë. KZAZ me numër 77 QV 4166 subjekti ABEOK, grupi i numërimit ka shënuar 1 votë, tabela përmbledhëse e rezultatit 0 vota, sistemi 0 vota. Mospërputhja e shifrave të konstatuara kryesisht nga KQZ u korrigjua në tabelën përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektin zgjedhor duke u bazuar nga origjinali i tabelave të qendrave të votimit, bazuar në nenin 123 të Kodit Zgjedhor. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse rezultati për kandidat për deputet për subjektet zgjedhore kryesisht u kontrolluan tabelat përmbledhëse nga ZAZ përkatëse dhe konstatohet se përfshihet rezultati i të gjithë tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të tyre. Në mbështetje të sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatë për deputetë me shifrat e korrigjuara të mbështetura në tabelat origjinale për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupi i numërimit për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit, përfaqësues të partive politike? Subjekte?

**Z. K. Merxhani:** Po përshëndetje, unë doja të mos ripërsërisja çështje të cilat kolegu im Bojken Abazi i përmendi për rastin e Tiranës. Kemi pothuajse të njejtat gjëra, nëqoftëse do të shtoja dy problematika përveç se mos lejimit të vëzhguesve tanë dhe nga ana e forcave të rendit të futjes brenda KZAZ ose ZAZ në momentin kur kanë ardhur kutitë e votimit. Por, doja të shtoja dhe faktin që në disa raste është konstatuar

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

që kamera e ekranit është shfaqur e pa fokusuar dhe kjo e vështirëson pak po themi konsultimin e atij materiali filmik. Nga ana tjetër personalisht në ZAZ numër 80 kam parë numërues të cilët kanë eliminuar përmes grisjes së fletës së votimit. Ndoshta kjo do të kostatohej prej kamerave 360 gradë. Nga ana tjetër doja të pyesja, më tepër të kërkoja një informacion për hapat që vetë KQZ ka ndërmarrë në lidhje me një video të cilën personalisht e kam denoncuar për sa i përket ZAZ numër 79 në Tepelenë. Ku manipulimi dhe deformimi i vullnetit të qytetarëve ka ndodhur pasi vëzhguesve i është komunikuar nga ana e komisionerëve që procesi është mbyllur. Pra, në ato momente ne kemi dhe dyshimin në qoftë se kamerat kanë funksionuar pas atij momenti ose jo, por kjo ngelet për t'u konstatuar. Ne do t'i ndjekim të gjithë hapat ligjorë, Ju sigurojmë për këtë! Sigurojmë dhe të gjithë mbështetësit tanë, por dhe të gjithë qytetarët shqipëtarë. Por, pyetja ime është a ka ndërmarrë KQZ një hap konkret në lidhje me një rast i cili është qartazi flagrant?! Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Sikurse e thashë dhe më herët ne jemi në proces verifikimi të të gjitha atyre pretendimeve që lidhen me mënyrën se si ka qenë sjellja e anëtarëve të komisionit në çdo lloj niveli dhe rikonfirmoj dhe njëherë që mbështesim çdo nisëm dhe çdo aksion të kujt do qoftë subjekt zgjedhor ose jo, për të denoncuar akte në të cilat janë përfshirë në mënyrë jo të ligjshme dhe me qëllim deformimin, apo me qëllim manipulimin e votës, ku ka qenë rasti nga ata komisionerë. KQZ është e gatëshme në dispozicion të çdo lloj informacioni filmik apo tjetër që i shërben zbardhjes të së vërtetës. Në lidhje me kamerat e mbikqyrjes 360 gradë që vendosen në VNV të ndryshme ato të cilat nuk i keni marrë do t'ua japim, nëse nuk i keni marrë.

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.4.05.2021*

**Z. K. Merxhani:** Mirë shumë faleminderit! Një pyetje tjetër shtesë veçanërisht për kandidatët e pavaruar të cilët nuk kanë atë strukturë të cilat kanë forcat partiake, afati 5 ditor, është pak shtrëngues për ne që të verifikojmë të gjithë këtë material. Shpresoj që të ketë një amendim të këtij afati, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Vetëm këtë nuk e ndyshojmë dot sepse është një afat i përcaktuar nga ligji, për të tjerat çfarë kemi në dorë mund ta bëjme, faleminderit! Mirë atëherë,  
1.Miratohet tabela përmbledhëse e rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë.  
2.Miratohet dhe tabela përmbledhëse e rezultatit për kandidatët për deputetë në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Sipas lidhjeve respektive bashkëlidhur këtij projektakti.

**Vendimi nr. 347**

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 18:05

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**  
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**  
2.Stafi KQZ:                              **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:**                      **PD, PS, LSI, PDIU**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të Qarku Fier përkatësisht KZAZ nr.54, KZAZ nr.55, KZAZ nr. 56, KZAZ nr. 57, KZAZ nr. 58, KZAZ nr. 59, KZAZ nr. 60, KZAZ nr.61 dhe KZAZ nr. 62 kanë miratuar dhe plotësuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela së bashku me tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të sipërcituara. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet zgjedhore, Qarku Fier kryesisht u

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021**

kontrolluan nga administrata e KQZ-së tabelat përmbledhëse të ZAZ-ve të kësaj zone zgjedhore. Gjithashtu rezultoi se tabelat përmbledhëse e rezultatit përfshinë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Gjithashtu përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për kandidatët për deputetë për subjektet zgjedhore, të KZAZ-së Qarku Fier kryesisht u kontrolluan me tabelat përmbledhëse të këtyre ZAZ-ve dhe rezultoi se përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Në mbështetje për sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore dhe tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputet për zonën zgjedhore Qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit të çdo ZAZ-je, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Diskutime nga përfaqësues të Partive Politike, të subjekteve zgjedhore?! Nuk kemi.

Atëherë, miratohet tabela përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Fier.

Miratohet tabela përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Fier sipas lidhjes së bashkëlidhur këtij vendimi.

**Vendimi nr. 348**

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

04.05.2021  
Ora 18:07

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e tabelës për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore qarku Lezhë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z.Illirjan Celibashi**
  - 2.Stafi KQZ:                                      **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:                                      PD, PS, LSI, PDIU**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

**Z. Y. Merkaj:** Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të Qarku Lezhë përkatësisht KZAZ nr.12, KZAZ nr.13, KZAZ nr. 14 dhe KZAZ nr. 15 kanë miratuar dhe plotësuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet të zonave përkatëse. Gjithashtu kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve këto tabela së bashku me tabelat origjinale të rezultateve për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të sipërcituara. Përpara plotësimit të tabelës përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për subjektet zgjedhore, Qarku Lezhë kryesisht u kontrolluan nga administrata e KQZ-së tabelat përmbledhëse të ZAZ-ve nr.12, nr.13,

**Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

nr.14, dhe nr.15 me tabelat origjinale të rezultatit për qendrat e votimit të këtyre ZAZ-ve, të plotësuar nga anëtarët e grupit të numërimit dhe rezultojnë se përfshihet rezultati i të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. U vërejtën mospërputhjet e shifrave në QV-të si më poshtë: KZAZ nr.12, QV 07171 flete votimi të dëmtuara grupi i numërimit 0, tabela përmbledhëse e rezultatit 24, sistemi 24. KZAZ nr.12, QV 0681, flete votimi të papërdorura, grupi i numërimit 184, tabela përmbledhëse e rezultatit 84, sistemi 84. Mospërputhjet e shifrave të konstatuara kryesisht nga KQZ-ja u korrigjuan në tabelën përmbledhëse të rezultateve të zonës zgjedhore, për subjektet zgjedhore, duke u bazuar në origjinalin e tabelave të qendrave të votimit, në zbatim të pikës 3 të nenit 123, të Kodit Zgjedhor. Përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit të zonës zgjedhore për kandidatët për deputetë për subjektet zgjedhore, kryesisht u kontrolluan tabelat përmbledhëse të rezultatit me tabelat e ZAZ-ve përkatëse dhe rezultoi se: Tabelat përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor të KZAZ-ve të sipërcituara përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve të tyre. Në mbështetje për sa më sipër i propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore me shifrat e korigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve të çdo QV-je, plotësuar nga grupi i numërimit si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe tabelat përmbledhëse të rezultatit për çdo ZAZ, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Diskutime nga përfaqësues të Partive Politike, të subjekteve zgjedhore?! Nuk kemi.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.05.2021*

Atëherë, miratohet tabela përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Lezhë.

Miratohet tabela përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Lezhë sipas lidhjes së bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Mbyllet shqyrtimi dhe i pikës së fundit të rendit të ditës! Seanca mbyllet, faleminderit!

*Vendimi nr. 349*

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*

